

FJALA E DEPUTETIT TONI GOGU

E ENJTE 14 PRILL 2022

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Ka një fakt shumë të thjeshtë: më 6 mars të këtij viti, vetëm 5 javë pasi Presidenti i Republikës kishte dekretuar zgjedhjet lokale për 6 bashki, gati 150 mijë qytetarë rrezikonin të mos e ushtronin të drejtën e tyre themelore për të votuar. 150 mijë qytetarëve u kishin skaduar kartat elektronike, nëpërmjet të cilave u mundësohet e drejta e votimit. Aplikimi për këto karta elektronike bëhet pranë zyrave të shërbimit postar. I madh dhe i vogël, në gjithë këtë glob, e di shumë mirë se ky planet nuk ka pasur një situatë më të vështirë se viti që kaluam, vetëm kolegët tanë të opozitës e kanë harruar këtë gjë.

Pra, të grumbullosh qytetarë në sportele në kushtet e pandemisë, është një lloj si të krijosh vatra infeksioni dhe ta përhapësh pandeminë me duart e tua. Prandaj, t'u mohosh qytetarëve të drejtën për të votuar për shkak se u ka skaduar karta e identitetit, do të ishte një tradhti tragjike për çdo deputet, i cili ka ardhur këtu për shkak se ata qytetarë kanë ushtruar të drejtën e votës. Por, gjithashtu, do të ishte një hipokrizi e qartë, për shkak se ky Kuvend ekziston për të kontrolluar qeverinë kur ushtron të drejtën e saj për të nxjerrë akte normative. Pra, qeveria, e gjendur përballë kësaj situate, vendosi të ushtrojë të drejtën që i jep neni 101 i Kushtetutës, në kushtet e nevojës dhe të urgjencës, nxjerrjen e aktit normativ që ne po shqyrtojmë sot, i cili më 6 mars u krijoi mundësinë të votonin gati 150 mijë qytetarëve të bashkive: Shkodër, Dibër, Lushnjë, Vorë dhe Rrogozhinë. Gjykata Kushtetuese e ka trajtuar gjerë e gjatë se kur e përdor qeveria këtë nevojë dhe thotë që nevoja dhe urgjenca janë përcaktuese.

Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese thotë që nevoja dhe urgjenca janë rrethana e situata, të cilat shkaktohen e bashkohen në një emërues të përbashkët në një situatë jo të zakonshme, kur rrezikohen të drejtat themelore të qytetarëve dhe interesat publike. A ka situatë më të pastër në dritën e diellit se sa të të mohohet e drejta e votimit?! Prandaj, nevoja dhe urgjenca e qeverisë për të miratuar këtë akt ishte për të garantuar të drejtën e votës. Përmes këtij akti normativ qeveria qytetarëve të Shkodrës, të Dibrës, të Lushnjës, të Vorës dhe të Rrogozhinës u garantoi mundësinë e ushtrimit të të drejtës së tyre për të zgjedhur zhvillimin ekonomik dhe atë infrastrukturor të qyteteve të tyre. Në qytetet e Vorës apo të Rrogozhinës, të cilat ishin të goditura nga tërmeti, qytetarët mund të vendosnin edhe për rindërtimin e qytetit të tyre, që të vazhdojë rindërtimi i lagjeve në shtëpitë ku ata tashmë kanë hyrë. Pra, vetëm për kolegët tanë nuk ekzistonte kjo nevojë dhe urgjencë, por sajohen histori me hajdutë.

E dyta, nevoja dhe urgjenca për të mbrojtur jetë. Që të testohen 1,7 milionë shqiptarë patjetër që qeveria do të nxjerrë akt normativ; që të shërohen mbi 280 mijë shqiptarë të infektuar nga Covid-i patjetër që qeveria do të nxjerrë akt normativ. Kjo shumicë socialistësh do t'i përdorë të gjitha të drejtat që i ka dhënë Kushtetuta kur bëhet fjalë për të mbrojtur jetën e qytetarëve të vendit të vet. Vetëm një

nevojë dhe një urgjencë ishte enigmë, nevoja dhe urgjenca e Presidentit për dekretuar zgjedhjet më 20 janar. Megjithatë, kjo është një enigmë e zgjidhur tashmë, të gjithë e dinë se çfarë e shtyu Presidentin ta ushtronte të drejtën e tij si “Kofini pas të vjelit”. Pra, për 150 mijë shtetasit e këtij vendi nuk ka pasur zgjidhje tjetër që t’u jepej e drejta e tyre themelore e ushtrimit së votës, përveçse nxjerrjes së aktit normativ që ne po shqyrtojmë sot.

Prandaj, ju ftoj të gjithëve që ta votoni aktin normativ, por, përpara se ta bëj këtë gjë, kam një kërkesë për kolegët e opozitës. Përpara se të përbetoheni për të drejtën e votës, unë ju kërkoj që të ushtroni ato detyra që na ngarkon ky parlament. Ky parlament na ngarkoi detyrën që zgjedhjet t’i hetonim së bashku; të hetonim shkeljet; të hetonim të gjitha shqetësimet që ngriheshin nga zgjedhjet dhe jo të bëjmë debat publik, duke ngritur disa akuza tërësisht mbi trillime. Nuk ka nevojë të qeshim, por të ushtrojmë detyrën tonë me seriozitet. Të qeshurën mund ta mbani në bashkësinë tuaj politike, madje do të ishte shumë mirë që aty të mbronit të drejtën e votimit, sepse aty fillon. Mbrojeni të drejtën e votës në bashkësinë tuaj politike, sepse për interesa personale jeni të gatshëm, dhe jo siç është rasti për interesa publike, të merrni, të digjni e të tymosni njëri-tjetrin dhe jo të mbronit të drejtën tuaj të votimit. Megjithatë, ju keni zgjedhur një rrugë dhe do ta ndiqni atë deri në fund. Prandaj, pa humbur kohë dhe pa ju marrë më shumë minuta, ju ftoj ta miratojmë aktin.